

"Ka q e vështirë, sepse..."



Ekspozitë me fota nga jeta e njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Faqe 5

Trajnim për trajnerë "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuara"



Faqe 4

FSHDPAK mbështet pushtetin lokal në hartimin e planeve lokale në fushën e arsimit, punësimit, përshatshmërisë dhe shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara

Faqe 4



Konferenca kombëtare "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, lobim dhe avokati për ratifikim"

Faqe 3



Nënshkrimi më 3 Dhjetor 2009 nga Qeveria Shqiptare i "Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara"

Faqe 2



Nënshkrimi më 3 Dhjetor 2009 nga Qeveria Shqiptare i "Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar"

Konsideruar rëndësinë e madhe të këtij instrumenti ndërkombëtar në funksion të promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, FSHDPAK ka qenë një nga organizatat më aktive në rang kombëtar që ka lobuar për nënshkrimin e saj edhe nga Qeveria Shqiptare.

Që në fillimet e hartimit të kësaj konvente, falë ndërhyrjes të Grupit të Avokatisë pranë FSHDPAK, në muajin Gusht 2004, për herë të parë, u bë e

mundur edhe pjesëmarrja e Shqipërisë, në një nga sesionet që dikutohej për këtë draft konventë. Kjo u realizua në saj të bashkëpunimit me Zv. Ministrin e jashtëm, të kohës, z. Luan Hajdaraga, ku FSHDPAK mori nismën për përfshirjen edhe të shtetit Shqiptar në hartimin e kësaj draft konvente.

Tashmë "Konventa e për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar" është aprovuar më 13 Dhjetor 2006, në New York nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, dhe ka hyrë në fuqi në 3

Maj 2008 (pas ratifikimit të 20-të nga shtetet anëtare, dhe pas ratifikimit të 10 të protokollit shtesë nga shtetet anëtare). Deri sot kjo Konventë është nënshkruar nga 143 vende dhe është ratifikuar nga 72 vende (ku nga këto pjesa më e madhe janë vende të Bashkimit Europian). Gjithashtu protokollit shtesë i saj është nënshkruar nga 87 vende dhe ratifikuar nga 45 vende.

Edhe Qeveria Shqiptare nuk ka vonuar të bëhet pjesë e kësaj konvente. Më 03.12.2009 "Konventa e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar" u nënshkrua në parim nga Qeveria Shqiptare. Ndërkohë që në datë 22 Dhjetor 2009 kjo Konventë është nënshkruar zyrtarisht edhe nga Ambasadori i Shqipërisë në New York.





Konferenca kombëtare "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuar, lobim dhe avokati për ratifikim"

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK) mbështetur nga FOSI- Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, organizoi në datë 10.11.2009 konferencën me temë "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuar, lobim dhe avokati për ratifikim".

Qëllimi i kësaj konference ishte ndërgjegjësimi i gjithë aktorëve përgjegjës në nivel kombëtar dhe rajonal me këtë instrument të ri ndërkombëtar në fushën e të drejtave

të njeriut, aprovuar më 13.12.2006 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, si dhe me domosdoshmërinë për ratifikimin e këtij dokumenti nga Qeveria Shqiptare.



Në këtë konferencë një vend të veçantë zuri prezantimi i dy ekspertëve ndërkombëtarë, Z. Simon Walker, Këshilltar për të drejtat e njeriut-Koordinator në Zyrën e UN Tiranë, i cili bëri një paraqitje të konventës dhe protokollit të saj opsional. Si dhe prezantimi i Zj. Marianne Schulze, Këshilltare për të drejtat e njeriut- GTZ e cila u përqëndrua në rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë OJF-të në lobimin dhe advokaci për ratifikimin e kësaj konvente nga Shteti Shqiptar. Prezantimet nga 2 aktivistët për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ofruan një përshkrim realist të ndikimit që do të ketë ratifikimi i Konventës në garantimin e të drejtave themelore, ende të munguar për to dhe komunitetin që ato përfraçojnë në Shqipëri.

Ndërkohë që hapat që duhet të ndërmarrë Shteti Shqiptar dhe detyrimet për zbatimin e kësaj konvente u prezantuan nga ekspertët e Ministrisë të Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Ministrisë të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSH). Një pjesë të rëndësishme të diskutimit ndërrmejt pjesmarrësve zuri draft-plani i masave i prezantuar nga dy ekspertët, me synim përshpejtimin e procesit të ratifikimit të kësaj konvente nga Qeveria Shqiptare.

Realizimi i kësaj konference dhe lobimi i vazhdueshëm i FSHDPAK që prej fillësive të hartimit të kësaj konvente nga OKB, u finalizua me nënshkrimin në parim të "Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar" nga Qeveria Shqiptare në 03.12.2009, dhe nënshkrimin e saj nga Ambasadori i Shqipërisë në New York në 22 Dhjetor 2009. Në vazhdim FSHDPAK po lobon për ratifikimin e kësaj konvente nga Parlamenti Shqiptar brenda vitit 2010.



Trajnim për trajnerë "Konventa e OKB për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuara"

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) gjatë muajit Tetor 2009, (në datat 5, 6 dhe 7 Tetor) realizoi trajnimin 3 ditor ToT me temë "Konventa e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ndërgjegjësim, instrumentat për ratifikimin dhe monitorim".

Ky trajnim u realizua me mbështetjen financiare të FOSI-Fondacioni i Shoqërisë së Hapur dhe

në të morën pjesë 15 anëtarë dhe drejtues të organizatave që punojnë në fushën e aftësisë të kufizuara, si dhe të rinj me aftësi të kufizuara lider dhe aktivistë të të drejtave të njeriut.

Moduli i trajnimit 3 ditor kishte për qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve me njohuritë teorike dhe praktike mbi konceptet bazë dhe instrumentat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimit të diskriminimit; Njohjen me përmbajtjen e Konventës së OKB

për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, instrumentat e ratifikimit dhe monitorimit të saj si dhe njohjen e pjesëmarrësve me mjetet e avokatisë që mund të përdoren nga shoqëria civile për nxitjen e procesit të ratifikimit të Konventës dhe më tej për zbatimin e saj nga Qeveria Shqiptare.

Trajnimi u realizua nga dy ekspertët e stafit të FSHDPAK dhe Z. Simon Walker, Këshilltar për të drejtat e njeriut- Koordinator në Zyrën e UN Tiranë. Po këta trajnerë u përfshinë në një trajnim me përfundim të Medias së shkruar dhe elektronike, organizuar në Tiranë, me synim ndërgjegjësimin e gazetarëve mbi këtë dokument të rëndësishëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe koordinimit të punës së Fondacionit me ta, në një proces të vazhdueshëm ndërgjegjësimi dhe avokues, në nxitje të ratifikimit dhe zbatimit të Konventës nga shteti shqiptar.

Pjesëmarrësit e përgatitur në ToT 3 ditor, janë përfshirë tashmë nga FSHDPAK në një seri të gjërë trajnimesh në 12 rajone të Shqipërisë mbi "Konventën e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara".

FSHDPAK mbështet pushtetin lokal në hartimin e planeve lokale në fushën e arsimit, punësimit, përshatshmërisë dhe shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara

Gjatë periudhës shtator 2009-Dhjetor 2009, stafi i FSHDPAK në bashkëpunim edhe me ekspertë të tjerë në fushën e arsimit, punësimit, përshatshmërisë dhe shërbimeve sociale, ka zhvilluar një aktivitet intensiv, në ndihmë të qeverisjes lokale, në 5 rrethet ku FSHDPAK vepron: Durrës, Elbasan, Korce, Shkoder, Vlorë dhe Tiranë, për hartimin e planeve lokale në fushat e sipërper mendura. Procesi i hartimit të planeve ishte gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje. Individë me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, përfaqësues të OJFve të fushës së AK, ofrues shërbimesh të sektorit publik dhe privat, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse lokale, të drejtuar dhe lehtësuar nga ekspertët përkatës, përmes punës individuale dhe në grup, përmes ushtrimesh të ndryshme, realizuan analizën SWOT, e cila ndihmoi në identifikimin e pikave të forta, dobësive dhe

mangësive, mundësive dhe potencialeve egzistuese, si dhe risqeve në 4 fushat, arsim, punësim, përshatshmëri dhe shërbime sociale Kjo analizë ndihmoi për një përcaktim të nevojave për ti detajuar ato në një plan ndërhyrje me prioritete, në përputhje me mundësitë dhe potencialet reale lokale, për 2 vitet e vazhdim 2010-2012. Planet lokale, produkt i një procesi me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, mban autorësinë e gjithë aktorëve përgjegjës dhe aktiv në fushën e aftësisë së kufizuara në nivel lokal.

Gjatë muajit Janar ky aktivitet, do të pasohet nga një orientim për buxhetim, kryesisht në fushën e shërbimeve sociale, për ti ardhur në ndihmë sa më mirë procesit të mirëqeverisjes në nivel lokal, si dhe në përmbushje të qëllimit final, respektimit të të drejtave dhe aksesit në shërbime për komunitetin e njerëzve me aftësi të kufizuara në qytetet e targetuara.





"Kaq e vështirë, sepse..."

Ekspozitë me fota nga jeta e njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Në 3 Dhjetor 2009, Ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (FSHHPAK) me mbështetjen e Komisionit Europian organizoi hapjen e ekspozitës "Kaq e vështirë, sepse...". Me anë të saj, thotë Znj. Blerta Çani, drejtore ekzekutive e FSHHPAK, synohet të hidhet dritë në realitetin shqiptar të personave me aftësi të kufizuara duke sjellë copëza nga jeta e vështirësitë e përditshme me të cilat ata ndeshen. Përmes fotove, të cilat flasin vetë, pasqyrohet gjendja, nevojat, por edhe shpresat e dëshirat e tyre. Ne mund të shohim përmes këtyre fotove realitetin ku ata jetojnë, mund të kuptojmë dhe të gjejmë 1000 përgjigje për pyetjen "Kaq e vështirë, sepse...". Është vërtetë e vështirë kur shërbimet e mjaftueshme mungojnë, kur mjetet ndihmëse e

asistive nuk njihen e nuk ekzistojnë, kur fëmijëve me aftësi të kufizuara u mohohet e drejta për të ndjekur shkollën me moshatarët e tyre, kur të rinjtë me aftësi të kufizuara u mohohet e drejta për t'u punësuar e kontribuar, kur jeton në një mjedis që të krijon barriera në infrastrukturë, por edhe qëndrime. E pranishme në këtë ekspozitë, Znj. Filloreta Kodra, Zv. Ministre e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansave të Barabarta, pasi vlerëson Ekspozitën, si një dimension i ri i paraqitjes së problematikës së aftësisë së kufizuar, shprehet se "Vendimi i Qeverisë shqiptare, i datës 2 Dhjetor 2009, për firmosjen e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shpreh vullnetin politik të Qeverisë

Shqiptare, për të ndërmarrë hapa të mëtijshëm në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe ofrimit të programeve dhe shërbimeve të nevojshme që do të bëjnë të mundur përmirësimin e jetës së PAK dhe familjarëve të tyre".

Ekspozita u ndoq nga shumë të ftuar, përfaqësues nga trupi diplomatik në Shqipëri, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, përfaqësues nga biznesi, individë me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, komuniteti i biznesit etj. Gjatë muajit Dhjetor, kjo ekspozitë u hap edhe në qytetet e Korçës dhe Shkodrës. Po kështu, me kërkesë të Këshillit Britanik, në Shqipëri, disa nga fotot e paraqitura në ekspozitë, janë vendosur dhe do të qëndrojnë në ambientet e zyrave të tyre, për tre muajt në vijim. Për realizimin e saj, u punua ngushtë me individë me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, me organizata dhe ofrues shërbimesh në fushën e aftësisë së kufizuar. Një rol shumë të rëndësishëm, për organizimin e ekspozitës, luajti edhe fotografja Jutta Bezenberg, Kjo ekspozitë përbën një risi në pasqyrimin e problematikës së mprehtë me të cilën ndeshen sot në Shqipëri personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.



Infrastrukturë dhe Transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara

Projekti "Infrastrukturë dhe Transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara", mbështetur nga Fondacioni Soros, synoi në nxitjen e procesit të realizimit të përshtatshmërisë në mjedis dhe transport për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Në kuadër të projektit u zhvilluan dy debate televizive, një në TV Skampa Elbasan dhe një në News 24 Tiranë si dhe një seminar kombëtar. FSHDPAK përgatiti dhe zhvilloi më 6 Nëntor 2009, Seminarin Kombëtar "Ndërtim dhe transport i përshtatur për personat me aftësi të kufizuara". Në seminar morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të prefekturës

Tiranë e Durrës, përfaqësues qarqesh, përfaqësues të bashkisë Tiranë, njëjësive bashkiake Tiranë dhe bashki të tjera të vendit, universiteti Polis, specialistë të urbanistikës e transportit. Në seminar morën pjesë edhe përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar, gjithsej 57 persona nga të cilët 35 femra. Përmes prezantimeve dhe diskutimeve u risoll në vëmendje të pjesëmarrësve kuadri ligjor tashmë i plotësuar për realizimin e mjedisit dhe transportit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht në lidhje me hapat që janë bërë për zbatimin e legjislacionit duke prezantuar arritje e mosarritje e duke nxjerrë përgjegjësitë. Pjesëmarrësit propozuan edhe rekomandime

konkrete për të nxitur zbatimin e legjislacionit për përshtatshmërinë ndërtimore, duke u fokusuar në rolin e pushtetit vendor. Dy debatet e organizuara në një nga kanalet me shikuar brenda dhe jashtë Shqipërisë, në News 24 dhe në TV Skampa Elbasan, synuan në bërjen prezente në media të problematikës për ndërtim e transport të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit. Këto ishin emisionet e para ku u debatua vetëm për problemin e përshtatshmërisë në mjedise dhe transport. Përmes debateve të realizuara u prezantua dhe u bë i njohur niveli i arritur i legjilacionit shqiptar në fushën e përshtatshmërisë për specialistët përgjegjës në institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor; për specialistët/biznesmenë në fushën e ndërtimeve; për përfituesit me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

Vodafone Foundation Albania mbështet personat me aftësi të kufizuar në zonat veriore të vendit

Fondacioni Vodafone Albania mbështet që prej pesë vitesh Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar për projektin e prodhimit të karrigeve me rrota. Mbështetja që jep Fondacioni Vodafone Albania, është vazhdimësi e një bashkëpunimi 5 vjeçar me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në realizimin e prodhimit të 620 karrigeve me rrota në punishten "Mirësia", e para punishte dhe aktualisht e vetmja në shërbim të prodhimit dhe shpërndarjes së karrigeve me rrota dhe aksesorëve lehtësues për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri. Mbështetja financiare ka siguruar edhe trajnimin për përdorimin e karrigeve me rrota, si dhe aktivitete të tjera rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar. Ofrimi i mjeteve ndihmëse për lëvizje dhe kompet e rehabilitimit aktiv kanë si synim themelor të garantojnë të drejtën për lëvizje, përfshirje dhe një cilësi më të mirë jetese për personat me aftësi të kufizuar, përdorues të

karrigeve me rrota në Shqipëri. Falë këtij projekti të mbështetur nga VFA gjatë vitit 2009, 90 persona me aftësi të kufizuar nga zonat veriore të vendit janë pajisur me karrige me rrota. Ata janë asistuar gjithashtu nga stafi i FSHDPAK, Shkodër me informacion dhe orientim ligjor për problematikën që ata i shqetësojnë. Për shpërndarjen e karrigeve me rrota tek përfituesit, nga FSHDPAK dhe me pjesëmarrjen e drejtorit ekzekutiv të VFA z. Albi Greva u organizua një ceremoni më 22 Dhjetor 2009 në ambientet e Hotel Europa Shkodër. Gjithashtu në kuadër të zbatimit të projektit "Shërbime mbështetese për personat me aftësi të kufizuar në zonat veriore të vendit, përdorues të karrigeve me rrota" më herët, nga data 22 deri me 25 Tetor 2009 u zhvillua në Mali i

Robit Golem Resort, Durrës, Kampi i Rehabilitimit Aktiv "Aftësim për jetesë të pavarur" për 40 persona me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre. Pjesëmarrësit në këtë kamp janë përdorues të rinj të karrigeve me rrota. Ata ishin nga rajone të tilla si; Malësi e Madhe, Lac, Lezhë, Mirditë, Shkodër etj.

Katër ditë aktivitet, të organizuara në plash, synuan të sjellin sëbashku personat me aftësi të kufizuara dhe familjarë të tyre, si një mundësi shumë e mirë, që jo vetëm të trajnohen, por edhe të kenë mundësi të pushojnë, kënaqësi që rrallë mund tju ofrohet gjatë jetës së tyre, duke organizuar aktivitete sociale, sportive, argëtuese etj. Kampi konsistoi një session të plotë trajnimi, duke përfshirë informacion dhe njohuri praktike mbi një sërë aspektesh të aftësisë së kufizuar. Pjesë e programit të kampit të rehabilitimit, ishte edhe një session trajnimi "Si të shkruajmë një projekt propozim të suksesshëm" të ofruar nga dy trajnerë të Këshillit Britanik. Trajnimi paraqiti shumë interes për pjesëmarrësit. Aktivitetet e projektit gjetën pasqyrim të gjerë në media.





Grupi i Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara

U finalizua në Dhjetor 2009 aktiviteti i grupit të Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara, si pjesë e projektit “Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore”, i realizuar me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, USAID. Gjatë periudhës Shtator - Dhjetor 2009 në disa takime rradhazi, anëtarët e GGIAK diskutuan dhe finalizuan Platformën me prioritetet

dhe masa për zbatimin e tyre për përmirësimin e situatës së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri dhe për ofrimin edhe për to të mundësive të barabarta për pjesëmarrje shoqërore. Kjo platformë u finalizua duke u plotësuar edhe me rekomandimet e Konferencës Kombëtare “Gratë me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri: Të Përfshira apo të Haruara?”, që FSHDPAK organizoi në Maj 2009. Kjo platformë do t’i dërgohet Qeverisë me kërkesën që të hartohet një strategji kombëtare me objektiva të qarta përmes të cilave të realizohet jo vetëm mosdiskriminimi i grave me aftësi të kufizuara, por fuqizimi dhe përfshirja e tyre e plotë

në jetën shoqërore, ekonomike e politike të vendit. Gjatë po kësaj periudhe përfaqësuese të grupimit kanë marrë pjesë në konferenca e seminare të ndryshme në nivel kombëtar, duke ngritur zërin e kërkuar që të mos jenë më të harruara, por të drejtat e tyre të jenë të përfshira në dokumenta politikë të vendit, në strategjitë, programet e aktivitetet e organizatave të sferës së barazisë gjinore dhe në ato të sferës të së drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe në programet e zhvillimit në përgjithësi të organizatave kombëtare e ndërkombëtare.

Koalicioni Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi

Më 17 Dhjetor 2009 u zhvillua një takim i hapur i Koalicionit Shqiptar Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi. Takimi u nxit nga kërkesa e anëtarëve të DDCA Save the Children dhe Fondacioni Shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ky takim pati në fokus shqetësimin për tërheqjen e vëmendjes së institucioneve shtetërore për sigurimin e të drejtës për arsim gjithpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përfaqësuesja e Save the Children bëri prezente domosdoshmërinë e finalizimit të nismës së ndërmarrë për përmirësimin e Dispozitave Normative, duke bërë pjesë e rishikimit të tyre rekomandimet e përgatitura nga grupi i ekspertëve që punuan nën drejtimin e kësaj organizate. Shqetësimi u vlerësua i drejtë nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës të cilët i kërkuar mbështetje Znj. Nora Malaj – zv.ministre e arsimit, e ftuar në këtë takim. Znj. Malaj u shpreh e gatshme të mbështesë këto përpjekje deri në realizimin e Dispozitave të reja normative gjithpërfshirëse.

Grupi i prindërve të personave me aftësi të kufizuara mendore paraqiti një deklaratë “Jo më diskriminim ligjor ndaj personave me aftësi të kufizuara mendore e shqisore” duke shprehur indinjatën në lidhje me indiferencën e qeverisë për miratimin e statusit për këtë kategori personash, të cilët vazhdojnë të jenë ende të diskriminuar në shoqërinë shqiptare. Në këtë takim morën pjesë edhe studentët të fakultetit të shkencave sociale, për të cilët diskutimet e zhvilluara shërbyen si një leksion i hapur për ta.

Federata Ndërkombëtare e Tenisit, mbështet zhvillimin e sportit të tenisit në karriker me rrota në Shqipëri

Federata Ndërkombëtare e Tenisit në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Tenisit dhe me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, prej disa muajsh, po punojnë për zhvillimin e sportit të tenisit në karriker me rrota në Shqipëri. Prej disa muajsh, një grup të rinjsh, përdorues të karriker me rrota, po luajnë, nën drejtimin e dy trajnerëve të Federatës Shqiptare të Tenisit, në ambientet ku kjo Federatë zhvillon aktivitetin e vet. Personat me aftësi të Kufizuara (PAK) kanë të drejtën të luajnë dhe të argëtohen. Përmes sportit, PAK mund të krijojnë aftësi sociale, të mësojnë si të fitojnë dhe humbasin, të shprehin potencialet e tyre sportive me synimin dhe ambicjen për tu organizuar dhe për të marrë pjesë edhe në gara, apo kampionate lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të ndihmuar në ofrimin e teknikave të lojës së tenisit në karriker me rrota, Federata Ndërkombëtare e Tenisit, përmes këtij projekti të mbështetur nga Siver Fund, mundësoi ardhjen në Shqipëri gjatë muajit Shtator, të Geraint Richards, për të organizuar sëbashku me trajnerët shqiptarë, një trajnim intensiv 5 ditor me grupin e të rinjve me aftësi të kufizuara. Përmes këtij aktiviteti, Federata Shqiptare e Tenisit, hap dyert dhe krijon akses për shërbimet e saj, edhe ndaj personave me aftësi të kufizuar, duke ofruar një model të një programi gjithpërfshirës zhvillimi.

Federata Shqiptare dhe ajo Ndërkombëtare e Tenisit, sëbashku me lojtarët me aftësi të kufizuara kanë ambicje dhe synime të cilat synojnë ti realizojnë gjatë vitit 2010.

ÇFARE ESHTË FSHDPAK

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, FSHDPAK është organizatë jofitimprurëse që prej vitit 1994, fillimisht si program i Oxfam-it për aftësinë e kufizuar në Shqipëri, dhe regjistruar prej vitit 1996 si një OJF e pavarur. Filozofia e FSHDPAK mbështetet në modelin social të aftësisë së kufizuar.

Misioni i FSHDPAK është promovim i shanseve të barabarta dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre.

STRATEGJIA

Për realizimin e misionit të tij FSHDPAK punon ngushtësisht me individë me aftësi të kufizuar dhe shoqata të tyre, shoqata që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe aktore të tjerë të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore e private, përmes zgjerimit e fuqizimit të partneriteteve, duke synuar në zhvillimin e fuqizimit të procesit të avokatisë e vet-avokatisë nëpërmjet informacionit, trajnimeve, ekspertizës ligjore e teknike dhe shërbimeve të tjera.

Programet e FSHDPAK ofrojnë

- Informacion në fushën e aftësisë së kufizuar
- Trajnim, Konsulencë dhe Ekspertize teknike
- Avokati dhe lobim me synim përmirësimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar
- Asistencë ligjore dhe avokat falas për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre
- Prodhim dhe shpërndarje të karrigeve me rrota(e vetmja e këtij lloji në Shqipëri
- Kampe të Rehabilitimit Aktiv për përdoruesit e karrigeve me rrota
- Punësim për njerëzit me aftësi të kufizuar
- Realizim i fushatave ndergjegjesuese përmes medias.

SFIDA 30

BASHKËPUNËTORË

Blerta Çani
Bardhylka Kospiri
Narbis Ballhysa
Florida Kalemi
Entila Zyba

DESIGN AND LAYOUT

Orest Muça

ADRESA

Rruga "Bogdani" (ish-A.Z.Çajupi) nr. 15,
kat i 3, Tiranë Shqipëri.

Tel: ++355 4 269426

E-mail: adrf@albmail.com

www.adrf.org.al